




# ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA

Rezultatet nga  
gjurmimi i të  
diplomuarve  
2021-2022



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



Ky raport është hartuar nga Jonida Jani nën kujdesin e Aleka Papa, Projekti “Aftësi për Punë” (S4J). Koordinator për gjurmimin në Shkollën “Fan Noli”.

### **Rreth projektit “Aftësi për Punë” S4J**

“Aftësi për Punë” S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

## Lista e figurave

Figura 1: Të diplomuar TIK (2020-20222).....	6
Figura 2: Shpërndarja sipas gjinisë (2022) .....	7
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2022) .....	7
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022) .....	8
Figura 5: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2022) .....	8
Figura 6: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2022) .....	9
Figura 7: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2022) .....	9
Figura 8: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2022).....	10
Figura 9:Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2022).....	10
Figura 10: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022.....	11
Figura 11: Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë me kohë të pjesshme (2022) .....	11
Figura 12: Madhësia e kompanisë (2022).....	12
Figura 13: Lloji i kontratës (2022).....	12
Figura 14: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2022).....	13
Figura 15: Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022).....	14
Figura 16: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2022).....	14
Figura 17: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2022).....	15
Figura 18: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2022).....	15
Figura 19: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2022).....	16
Figura 20: Arsyet kryesore pas papunësisë (2022) .....	16
Figura 21: Metodatat e kërkimit për punë (2022).....	17
Figura 22: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2022) .....	17
Figura 23: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2022).....	18

## Lista e tabelave

Tabela 1: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2022).....	13
Tabela 2: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2022).....	18
Tabela 3: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2022) .....	19

## Tabela e përmbajtjes


<b>1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve? .....</b>	<b>5</b>
<b>2. Të diplomuarit 2020-2022 .....</b>	<b>6</b>
<b>3. Analiza e rezultateve.....</b>	<b>8</b>
<b>3.1 Statusi i punësimit.....</b>	<b>8</b>
<b>3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit .....</b>	<b>9</b>
<b>3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës .....</b>	<b>10</b>
<b>3.4 Niveli i pagave.....</b>	<b>10</b>
<b>3.5 Kushtet e punës .....</b>	<b>11</b>
<b>3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës.....</b>	<b>13</b>
<b>3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë.....</b>	<b>13</b>
<b>3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë.....</b>	<b>14</b>
<b>3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme .....</b>	<b>15</b>
<b>3.10 Të diplomuarit pa punë.....</b>	<b>16</b>
<b>3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë .....</b>	<b>18</b>
<b>3.12 Planet për të ardhmen .....</b>	<b>19</b>
<b>4 Përfundime .....</b>	<b>19</b>

## 1. Hyrje – Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

**Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës** për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes ‘studimeve gjurmuese’ që ndjekin ose ‘gjurmojnë’ të diplomuarit pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.


### Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, shkolla **“Fan Noli”**, me mbështetjen e projektit ‘Aftësi për Punë’ (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

- Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
- Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i

maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësi të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësi të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.


Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njesisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit 'Aftësi për punë'.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **brezitet të parë me të diplomuar** të shkollës "Fan Noli".

## 2. Të diplomuarit 2020-2022


Në vitin shkollor 2021-2022, në shkollën "Fan Noli", u diplomuan 49 nxënës. Gjatë katër viteve të fundit shkolla ka diplomuar 92 nxënës (shiko figurën 1).

Figura 1: Të diplomuar TIK (2020-20222)



Nga të diplomuarit e vitit 2021-2022 u gjurmuan 36 nxënës ose 73% e të diplomuarve. Të disgreguar sipas gjinisë janë gjurmuar 29 meshkuj dhe 7 femra (shiko figurën 1).


Figura 2: Shpërndarja sipas gjinisë (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=36

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 83% (N=30) e të diplomuarve të gjurmuar u shprehën se jetojnë në Shqipëri dhe 17% (N=6) jashtë Shqipërisë. Nga të diplomuarit që jetojnë jashtë Shqipërisë: dy jetojnë në Gjermani dhe dy të tjerë në Greqi. Ndërkohë, një i diplomuar i gjurmuar jeton në Angli dhe një tjetër në Maqedoni.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=36

### Disa nga gjetjet nga paragjurmimi i të diplomuarve në 2021:

- 100% (159 nga 159) e maturantëve u bënë pjesë e paragjurmimit;
- 37% e të gjurmuarve ishin në marrëdhënie pune - 56% në drejtimin Mekanikë (26 nga 46 të gjurmuar), 46% SHMT (18 nga 39), 26% në Elektroteknikë (6 nga 23), 20% në TIK (7 nga 34) dhe 12% në Termohidraulikë (2 nga 17);
- 49% të rasteve puna ka lidhje me degën e studiuar – 0% Termohidraulikë, 33% Elektroteknikë, 43% TIK, 44% SHMT, 58% Mekanikë;
- Format e vetme se si maturantët kanë gjetur punë: i) nëpërmjet njoftimeve për punë, 29%; ii) nëpërmjet njohjeve familjare (71%);
- 69% e të paragjurmuarve dëshirojnë të bëhen pjesë e tregut të punës pas diplomimit;


- 22% dëshirojnë të emigrojnë jashtë Shqipërisë.

### 3. Analiza e rezultateve

#### 3.1 Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të parë të të gjurmuarve (2021-2022), nga një total prej 36 të anketuarish 17 (47%) ishin të punësuar, 2 (6%) ishin të vetëpunësuar dhe 3 (8%) ishin student/kursant një vit pas diplomimit. Ndërkohë, të papunë ishin 14 (39%) të diplomuar të gjurmuar një vit pas diplomimit.


Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=36

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Për vitin 2022, 47% (N=17) e të diplomuarve të gjurmuar janë të punësuar dhe 6% (N=2) janë të vetëpunësuar.

Figura 5: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2022)




**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=36

### 3.2 Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 68% e të anketuarve u shprehën që puna nuk lidhet me fushën e tyre të arsimit dhe vetëm 32% (N=6) u shprehën që puna lidhet me fushën e tyre të arsimit.


Figura 6: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=19

Të pyetur më tej lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko figurën 7), vërehet se të diplomuarit e brezit 2021-2022 japin dy arsye kryesore: (i) pamundësia për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet (46%) dhe (ii) puna aktuale ofron pagë/kushte më të mira (36%)

Figura 7: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2022)




**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=11

### 3.3 Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko figurën 8), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në 2022 tregojnë se njohuritë përdoren “shumë/jashtëzakonisht shumë” nga 32% e të diplomuarve. Ndërkohë, 37% e të diplomuarve pohojnë që i përdorin “aspak/pak” njohuritë dhe 32% i përdorin disi njohuritë e fituara gjatë studimeve.


Figura 8: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=19

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko figurën 9), 22% e të diplomuarve në vitin 2022 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Nga ana tjetër, 47% e vlerësojnë me “pak/aspak” lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimit. Ndërkohë, 32% e të diplomuarve të gjurmuar e vlerësojnë disi lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimit.

Figura 9: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2022)




**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=19

### 3.4 Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2022 (shiko figurën 10), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 16% më pak se paga minimale, 37% paga minimale - 35,000 lekë, 16% paguhen 35,001 – 50,000 lekë, 5% paguhen 50,001 – 65,000 lekë dhe 5% paguhen 65,001 – 80,000 lekë. Ndërkohë, 21% marrin një pagë më të lartë se 80,001 lekë.

Figura 10: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2022




**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=19

### 3.5 Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), 94% e të diplomuarve të gjurmuar janë shprehur se punojnë me kohë të plotë dhe 6% punojnë me kohë të pjesshme. E shprehur në numër absolut, një i diplomuar punon me kohë të pjesshme.


Figura 11: Punësimi me kohë të plotë përkundrejtë me kohë të pjesshme (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=17

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 12), në brezin e të diplomuarve në 2022 vërehet se përkatësisht 35% e të diplomuarve janë të punësuar në kompani me 1-4 punonjës dhe po aq në kompani me 10-49 punonjës. Ndërkohë, 6% janë të punësuar në kompani me 5-9 punonjës dhe 24% në kompani me më shumë se 50 punonjës.


Figura 12: Madhësia e kompanisë (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=17

Në vitin 2022, 64% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 13). Nga ku, 35% kanë një kontratë pune me afat të pacaktuar dhe 29% me afat të caktuar. Ndërkohë, 35% nuk kanë një kontratë. E shprehur në numër absolut, 6 (gjashtë) të diplomuar të gjurmuar nuk kanë një kontratë pune me punëdhënësin.


Figura 13: Lloji i kontratës (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=17

Sipas rezultateve të gjurmimit 77% e të diplomuave të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 14). Ndërkohë, 18% deklarojnë se nuk iu paguhen sigurimet nga punëdhënësi dhe 6% shprehen se nuk kanë informacion nëse iu paguhen apo jo sigurimet.

Figura 14: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=17

### 3.6 Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqshmërinë me vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 70% e të diplomuarve në vitin 2022, u shprehën se ndjehen “të sigurt ose shumë të sigurt” (shiko tabelën 1). Vetëm një i diplomuar i gjurmuar (6%) ka pohuar se ndjehet “shumë i/e pasigurt”.

Ndërkohë, të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 66% e të diplomuarve në vitin 2022 shprehen se ndjehen “të kënaqur ose shumë të kënaqur” dhe vetëm 6% u shprehen “shumë të pakënaqur”. Sikurse e tregon edhe tabela 1, vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.

Tabela 1: Përceptimi për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2022)


Shumë i/e pasigurt	6%	Shumë i/e pakënaqur	6%
As i sigurt as i pasigurt/ neutral	24%	As i kënaqur as i pakënaqur/ neutral	6%
I/e sigurt	41%	I/e kënaqur	47%
Shumë i/e sigurt	29%	Shumë i/e kënaqur	19%

**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=17

### 3.7 Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 38% e të diplomuarve në vitin 2022 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punën para diplomimit, 10% janë punësuar 1 muaj pas diplomimit, 14% janë punësuar 1 – 3 muaj pas diplomimit, 19% janë punësuar 3 – 6 muaj pas diplomimit si dhe 10% janë punësuar 6 – 9 muaj pas diplomimit. Ndërkohë, 10% e të diplomuarve kanë arritur të gjejnë punë 9 - 12 muaj pas diplomimit.

Figura 15: Periudha kohore në kërkim të një pune (të diplomuarit 2022)




**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=21

### 3.8 Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, sikurse e tregon edhe figura 16, dy janë mënyrat mbizotëruese të gjetjes së punës së parë: (i) nga njohjet, lidhjet familjare dhe miqtë (67%), dhe (ii) nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale dhe gazeta (19%).


Figura 16: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=21

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko figurën 17), në vitin 2022, 42% e të diplomuarve të gjurmuar pohuan se shkolla i ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit, 37% shkolla u ka mësuar si të kërkojnë dhe aplikojnë për punë dhe 16% i ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë. Ndërkohë, tre të diplomuar (16%) shprehen se përgjithësisht shkolla nuk i ka ndihmuar në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës.

Figura 17: Ndhimja e shkollës në gjetjen e punës së parë (2022)




**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=36

### 3.9 Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Tre të diplomuar të gjurmuar (8%) janë shprehur se janë student/kursant një vit pas diplomimit. Të tre të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme, janë shprehur se janë duke vijuar studimet universitare në një institucion publik. Për më tepër, të tre pohojnë se fusha e studimeve universitare që po ndjekin lidhet me shkollën që kanë bërë.

Të pyetur më tej mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko figurën 18), 67% e të diplomuarve të gjurmuar janë përgjigjur se arsyeja kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme është për të fituar një kualifikim më të lartë dhe 33% për të rritur mundësinë për të gjetur një punë më të mirë.

Figura 18: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2022)




**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=3

### 3.10 Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit është 39%. E shprehur në numër absolut 14 nga 36 të diplomuarit e anketuar janë të papunë një vit pas diplomimit. Të pyetur nëse po kërkonin punë, 12( 86%) prej të diplomuarve të papunë u shprehën se po kërkonin punë (shiko figurën 19). Ndërkohë, 2 (14%) pohuan se ishin pa punë, por nuk po kërkonin për punë.


Figura 19: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=14

Të pyetur për arsyet e papunësisë, 4 (33%) të diplomuar të papunë kanë pohuar se u mungon eksperiencia në punë. Ndërkohë, 2 (17%) kanë pohuar se oferta për punë nuk lidhet me arsimimin, 2 (17%) nuk kanë njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur punë dhe 2 (17%) të tjerë shprehen se nuk ka punë në qarkun e tyre. Për më tepër, 1 (8%) është shprehur se njohuritë që ka marrë në shkollë nuk përputhen me tregun e punës dhe 1 (8%) se nuk di si të kërkojë për punë.


Figura 20: Arsyet kryesore pas papunësisë (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=12

Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend pune (shiko figurën 21), për vitin 2022 ka një përqindje të barabartë të të diplomuarve që pohojnë se kërkojnë punë nëpërmjet njoftimeve për punë në faqe interneti, media sociale, gazeta (42%) dhe nëpërmjet njohjeve, lidhjeve familjare, miqve dhe të njohurve (42%). Ndërkohë, 25% gjejnë punë përmes shkollës dhe 17% duke kontaktuar drejtëpërdrejtë me bizneset (duke dërguar CV etj).


Figura 21: Metodatat e kërkimit për punë (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=12

Sikurse e tregon edhe figura 22, vetëm 29% (N=4) e të diplomuarve të cilët janë të papunë kanë qenë më herët në marrëdhënie pune. Ndërkohë, 71% (N=10) e të diplomuarve të papunë nuk kanë qenë më parë në marrëdhënie pune.

Figura 22: Niveli i të diplomuarve papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2022)



**Shënim:** Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza:** N=14

### 3.11 Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën 2 kanë “shumë/jashtëzakonisht shumë” nevojë për përmirësim. Theksi është tek nevoja për përmirësimin e bashkëpunimit me bizneset (75%), praktikës në shkollë (68%) dhe praktikës në biznes (68%). Për më tepër, kërkohet përmirësimi i teksteve dhe materialeve (66%) si dhe bashkëpunimi me zyrat e punësimit (66%).

Tabela 2: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2022)


Infrastruktura	55%
Kurrikula	44%
Tekstet dhe materialet	66%
Metodat e mësimdhënies	57%
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve	60%
Praktika në shkollë	68%
Praktika në biznes	68%
Këshillimi i karrierës	60%
Bashkëpunimi me bizneset	75%
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	66%

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. Baza: N=29

Nëse do të kishin mundësi, 78% e të diplomuarve në vitin 2022 do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe 75% të njëjtën shkollë (shiko figurën 23).

E shprehur në numër absolut 28 nga 36 të diplomuarit e gjurmuar do të zgjidhnin të njëjtën degë studimi dhe 27 nga 36 do të zgjidhnin të njëjtën shkollë. Ndërkohë, 8 nga 36 të diplomuar të gjurmuar nuk do e zgjidhnin të njëjtën degë studimi dhe 9 nga 36 nuk do zgjidhnin të njëjtën shkollë.

Figura 23: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2022)



Shënim: Rezultatet janë rumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rumbullakosjes, shumta e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. Baza: N=36

### 3.12 Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimit të mëtejshëm (shiko tabelën 3), 39% e të diplomuarve të gjurmuar shpresojnë të kenë ngritur biznesin e tyre. Ndërkohë, 28% shpresojnë të kenë gjetur punë dhe 25% të kenë gjetur punë që lidhet me fushën e tyre të studimit. Për më tepër, 28% shpresojnë të ndjekin studime të mëtejshme dhe 22% të emigrojnë jashtë vendit.

Tabela 3: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2022)

Të jem punësuar	28%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	25%
Të kem filluar biznesin tim	39%
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	28%
Të kem emigruar jashtë vendit	22%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	3%
Tjetër	3%

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. Baza: N=36

## 4 Përfundime

Në këtë raport paraqiten rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të shkollës “Fan Noli” për brezin e nxënësve të diplomuar në vitin 2022.

### Disa nga gjetjet kryesore të gjurmimit për të diplomuarit e 2022 janë përmbledhur më poshtë:

- 73% e të diplomuarve të 2022 u gjurmuan një vit pas diplomimit.
- Nga një total prej 36 të anketuarish, 47% ishin të punësuar, 6% ishin të vetëpunësuar dhe 8% ishin student/kursant një vit pas diplomimit. Ndërkohë, të papunë ishin 39% e të diplomuarve të gjurmuar një vit pas diplomimit.
- 68% e të anketuarve u shprehën që puna nuk lidhet me fushën e tyre të arsimit dhe vetëm 32% u shprehën që puna lidhet me fushën e tyre të arsimit.
- Përqindja e të diplomuarve që janë shprehur se i përdorin njohuritë në vendin e punës “shumë/jashtëzakonisht shumë” për vitin 2022 është 32%. Ndërkohë, 37% e të diplomuarve janë shprehur që i përdorin “aspak/pak” njohuritë e fituara gjatë studimeve në vendin e punës.
- Për vitin 2022, shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 16% më pak se paga minimale, 37% paga minimale - 35,000 lekë, 16% paguhen 35,001 – 50,000 lekë, 5% paguhen 50,001 – 65,000 lekë dhe 5% paguhen 65,001 – 80,000 lekë. Ndërkohë, 21% marrin një pagë më të lartë se 80,001 lekë.
- 38% e të diplomuarve në vitin 2022 kanë gjetur punë para diplomimit, 10% janë punësuar 1 muaj pas diplomimit, 14% janë punësuar 1 – 3 muaj pas diplomimit, 19% janë punësuar 3 – 6 muaj pas diplomimit si dhe 10% janë punësuar 6 – 9 muaj pas diplomimit. Ndërkohë, 10% e të diplomuarve kanë arritur të gjejnë punë 9 - 12 muaj pas diplomimit.

- Të diplomuarit përgjithësisht ndihen të sigurt dhe të kënaqur në punën e tyre aktuale, ku rreth 70% e tyre janë përgjigjur “të sigurt/shumë të sigurt” dhe 66% “të kënaqur ose shumë të kënaqur”. Vërehet një korrelacion pozitiv mes sigurisë dhe kënaqësisë në vendin e punës.
- Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit është 39%. Në numër absolut kjo shkon në 14 të papunë. Të pyetur nëse po kërkojnë për një mundësi punësimi, 86% janë përgjigjur po.
- Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2022, të gjurmuarit vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim “shumë/jashtëzakonisht shumë”. Përkatesisht bashkëpunimi me bizneset (75%), praktika në shkollë (68%), praktika në biznes (68%), tekstet dhe materialet (66%) si dhe bashkëpunimi me zyrat e punësimit (66%) kanë “shumë/jashtëzakonisht shumë” nevojë për përmirësim.
- Brenda dy viteve të ardhshme, 39% e të diplomuarve të gjurmuar shpresojnë të kenë filluar biznesit e tyre, 28% të kenë gjetur punë, 25% të kenë gjetur punë që lidhet me fushën e tyre të studimit, 28% të ndjekin studime të mëtejshme si dhe 22% të emigrojnë jashtë vendit.